



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 17 dhe 18 dhjetor, u bënë publike tri marrëveshje më vete për pranimin e fajësisë, në të cilat Sabit Januzi, Haxhi Shala dhe Ismet Bahtijari pranuan secili fajësinë për një akuzë për frikësim dhe një akuzë për pengim.

Në seancat e mbajtura më 18 dhjetor, z. Januzi dhe z. Shala pranuan secili fajësinë për një akuzë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për frikësim, sipas përkufizimit në nenet përkatëse të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe Ligjit të DHSK-së.

Në seancën e 18 dhjetorit u diskutuan edhe aspekte të tjera lidhur me marrëveshjet për pranimin e fajësisë, ku të pandehurit konfirmuan se i kishin diskutuar marrëveshjen me avokatët e tyre, dhe se i kishin kuptuar marrëveshjet dhe pasojat e saj. Të pandehurit konfirmuan gjithashtu se ata u pajtuan me vullnet të lirë me marrëveshjen dhe se hoqën dorë nga e drejta për t'u gjykuar.

Një seancë e ngjashme për të diskutuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë nga z. Bahtijari filloi sot pasdite.

Marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe çështje të lidhura me to, si dënimi, janë ende duke u shqyrtuar nga Trupi Gjykses.

Në çështjen gjyqësore të *Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit*, që ka të bëjë me ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, të martën më 17 dhjetor, u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes. Aty u diskutuan nxjerrja e provave nga Prokuroria për Mbrojtjen dhe aspekte të tjera lidhur me përgatitjen e shpejtë të çështjes gjyqësore për gjykim.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Administratorja njoftoi Gjykatësen e Procedurës Paraprake më 13 dhjetor lidhur me miratimin me kusht të znj. Sofi Menegon (Sophie Menegon) si bashkëmbrojtëse të z. Thaçi.

Në çështjen tjetër gjyqësore të *Hashim Thaçit Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, që ka të bëjë me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, Trupi Gjykses lëshoi një vendim të ri mbi pjesëmarrjen e viktimave në proces, më 16 dhjetor, sipas të cilit një parashtrues kërkese u pranua për të marrë pjesë në proces. Ky vendim e çon numrin e gjithsejtë të viktimave pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor në 154.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 13 dhjetor, Trupi Gjykses mori vendim mbi një kërkesë të Prokurorisë për të pranuar si prova dëshmitë me shkrim të disa dëshmitarëve pa u marrë në pyetje nga pala kundërshtare, me të cilin pranoi gjashtë dëshmi, hodhi poshtë pranimin e njëres, dhe shtyu marrjen e vendimit për një dëshminë e një dëshmitari tjetër, deri kur ZPS-ja të përmbushë kushtet e rregullës përkatëse.

1





Më 16 dhjetor, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Prokurorisë për të pranuar si prova deklaratat e mëparshme të një dëshmitari dhe në një vendim tjetër miratoi pjesërisht një kërkesë lidhur me dëshmitë e tre dëshmitarëve ekspertë.

Më 13 dhjetor, në vendime më vete, Trupi Gjykses vazhdoi paraburgimin e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, duke konstatuar se vijon të ekzistojë rrezik i mjaftueshëm që ata të pengojnë ecurinë e procesit të DHSK-së dhe të kryejnë krime të tjera kundër atyre që perceptohen si kundërshtarë të UÇK-së, përfshirë kundër dëshmitarëve që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në çështjen gjyqësore dhe/ose pritet të paraqiten para Dhomave të Specializuara. Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se këto rreziqe mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit.

Pushimi i dimëror i DHSK-së fillon të hënën, 23 dhjetor dhe zgjat deri të premten, 10 janar 2025. Gjatë kësaj periudhe, nuk do të ketë seanca, dhe disa shërbime jothelbësore do të funksionojnë në nivel minimal. Megjithatë, gjykata do të jetë në funksionim të plotë dhe puna do të vijojë si zakonisht në të gjitha njësitet e DHSK-së.

Gjatë pushimit mund të dorëzohen parashtrime, përveç nëse gjykatësit urdhërojnë ndryshe, dhe afatet gjyqësore vijojnë të jenë në fuqi.

Përditësimi i ardhshëm i DHSK-së për median është caktuar për të enjten, 9 janar 2025 në orën 14:30.

Seanca e ardhshme para DHSK-së është caktuar për janar 2025, në orën 09:00 në gjykimin e *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*.

